



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1083/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mandushe Shabani kandidate për anëtare të kuvendit komunalë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Pejë, paraqitur kundër Komisionit Qëndror Zgjedhor (KQZ), për shkak të publikimit të rezultateve përfundimtare për anëtarë të kuvendit komunalë në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Mandushe Shabani kandidate për anëtare të kuvendit komunalë në Pejë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Mandushe Shabani kandidate për anëtare të kuvendit komunalë në Pejë, në të cilën pretendon se është e bindur se ka pasur vjedhje të votave nga KQZ-ja në të gjitha fshatrat e komunës së Pejës. Kurse sa i përket asaj është e bindur për këto qendra ku i është konfirmuar se i ka 0 vota e është e informuar nga persona të besueshëm që kanë marr pjesë si vëzhgues në këto qendra se ka pasur vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1083/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.